



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0118**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar, Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik - Lulzim Eq. Gashi B.I. (NTP “Air Tours”- Suharekë), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim-elektrik etj për Administratë ,QKMF dhe shkolla me nr. të prokurimit: 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Komuna e Suharekës, në cilësinë e autoritetit kontraktues, me datën 01/06/2023, mori:

### **Vendim**

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE “Lulzim Eq. Gashi B.I.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 02/03/2023, numër protokolli 2023/0118, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim - elektrik etj për Administratë ,QKMF dhe shkolla me nr. të prokurimit: 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Komuna e Suharekës, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 15. 02. 2023 për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim - elektrik etj për Administratë, QKMF dhe shkolla me nr. të prokurimit: 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Komuna e Suharekës.
3. Konform nenit 31 pika 5 të Rregullores së Punës së OSHP, i behet konfiskimi i tarifës së parashtrimit të ankesës të cilat mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-se.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 15.02.2023, Komuna Suharekë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshtatur (numër, datë dhe emërtim) si në hyrje të këtij Vendimi, përderisa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte me 03.06.2023.

Me datën 21.02.2023 OE “Lulzim Eq. Gashi B.I.”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, e cila është refuzuar si e pabazuar me 22.02.2023

Me 02.03.2023, OE “Lulzim Eq. Gashi B.I.” në rastin konkret, kundër vendimit të cituar si më sipër kishte parashtruar Ankesë në OSHP, numër protokolli **118/23**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 169,000.00 €.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Me 09.03.2023, OSHP kishte angazhuar ekspertin shqyrtues që sipas autorizimeve të tija, të parapara me nenin 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë vlerësimin paraprak të dosjes dhe pretendimeve ankimore, i cili kishte rekomanduar panelit shqyrtues që ankesa e OE “Lulzim Eq. Gashi B.I.” të hudhet si e pa lejuar. Kurse Njoftimi, cituar si më sipër) mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Operatori ekonomik ankues “NTP Air Tours” -Suhareke si palë e pa kënaqur me datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 118/2023.

Ekspertja shqyrtuese sqaron kronologjinë dhe rrjedhën për këtë procedurë, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP. Herën e parë të vlerësimit të ofertave, AK kishte publikuar Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 30.06.2022 përmes të cilit vendim kishte rekomanduar për kontratë OE “NTP Air Tours”, ndërsa i pa kënaqur me këtë vendim dhe me arsyet e eliminimit nga autoritetit kontraktues operatori ekonomik Bajraktari “B.I Bau Center”-Suhareke kishte parashtruar ankesë në OSHP me nr.264/22, kurse në bazë të ankesës ishte nxjerr raport i ekspertizës me nr. 264/2022 dhe pasuar me vendimin PSH.nr.264/22 i datës 06.09.2022. sipas raportit të ekspertit dhe vendimit të Panelit Shqyrtues, lënda ishte kthyer në ri vlerësim.

Pas ri-vlerësimi të ofertave sipas vendimit PSH.nr.264/22 të datës 06.09.2022, AK Komuna Suhareke publikon Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.09.2022 duke e propozuar për dhënie të kontratës grupin e operatoreve ekonomik “Bekim Bajraktari B.I.; TRENDY HOME SH.P.K.-Suhareke. I pa kënaqur me këtë vendim, operatori ekonomik “NTP Air Tours” –Suhareke parashtron ankesë në OSHP me nr.671/22. Pas shqyrtimit të ankesës, eksperti i cili kishte trajtuar lëndën, në raportin e ekspertizës kishte propozuar që ankesa e operatorit ekonomik “NTP Air Tours” –Suhareke, të aprovohet si e bazuar dhe kishte propozuar që lënda të kthehet në ri vlerësim me qëllim që të trajtohen çmimet/pozicionet të cilat i ka kontestuar operatori ekonomik “NTP Air Tours” –Suhareke, në ankesën me nr. 671/2022 të datës 17.11.2022.

Pas trajtimit të ankesës së OE ankues “NTP Air Tours” –Suhareke, Paneli Shqyrtues nxjerr vendimin PSH.nr.671/22 të datës 03.02.2022, ku në dispozitivin e parë e refuzon ankesën e operatorit ekonomik si të pa bazuar, kurse në dispozitivin e dytë e anulon vendimin e Autoritetit

Kontraktues duke e kthyer lëndën në rivlerësim.

Pastaj, me datë 06.02.2023, Paneli Shqyrtues nxjerr konkluzion në të cilin ndryshohet/plotësohet Vendimi me nr. të protokollit 671/22 të datës 03.02.2023, ku dispozitivin 2, 4 dhe 5 ANULON, ndërsa mbetet në fuqi njoftimi i AK-së i datës 27.09.2022 për dhënie të kontratës, si dhe i bëhet konfiskimi i depozitës së ankesës.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me çështjen e vendimit PSH.nr.671/22 dhe Konkluzionin 671/22 të datës 06.02.2023, sqaron se nuk ka kompetencë që të bëjë interpretimin e vendimit dhe konkluzionit të nxjerr nga Paneli Shqyrtues.

Hierarkia institucionale në OSHP, e përcaktuar në LPP është që eksperti shqyrtues përpilon raport me shkrim për Panelin Shqyrtues, ku par. 2 i nenit 114 i LPP-së ka përcaktuar që eksperti mund të rekomandojë veprime korrigjuese që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues, por jo nga Paneli Shqyrtues. Sido që të jetë, në vendimin PSH.nr.671/22 të datës 03.02.2023 dhe në Konkluzionin Nr.671/22 të datës 06.02.2023, përmes këshillës juridike, palës nuk i lejohet ankesa por me kërkesë padi mund ti drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh.

Pa dashur të komentojmë vendimin PSH.nr.671/22 të datës 03.02.2023 dhe Konkluzionin Nr.671/22 të datës 06.02.2023 për shkak të mos pasjes së kompetencës ligjore të ekspertit, konsideroj se nëse e marrim Konkluzionin PSH.nr.671/22 të datës 03.02.2023 si akt përfundimtar të nxjerr nga OSHP, ekspertja shqyrtuese vlerëson se ankesa është e palejuar sepse OSHP në konkluzionin në fjalë e ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se pala mund ti drejtohet Gjykatës kompetente me kërkesë padi.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të anekses dhe procedurës së prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, ankuesin e cilëson si pale pa interes juridik material, ku ndër të tjera paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 103 të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtresuesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë

të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP dhe për këtë çështje juridike është dhënë një vendim me nr. 671/22 dhe Konkluzionin 671/22 të datës 06.02.2023, nga paneli shqyrtues me pare duke u lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktues.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet e palejuar.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.671/22, dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

*ndim –*

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Lulzim Eq. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: